



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	26.07.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	4330/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.575/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.575/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike “kompensim material”, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.575/2022 e datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme/Agjencinë e Regjistrimit Civil sipas Akt emërimit me numër Ref.DRGJC/ARC-1/3 të datës 31.01.2013 është në vendin e punës “Koordinator i QKRC Gjilan” në Departamentin e Regjistrimit dhe Gjendjes Civile Njësia QKRC Gjilan, sipas Vendimit me numër 07 të datës 05.02.2020 të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencionit për Regjistrimin Civil ankuesi është caktuar Ushtrues i Detyrës “Udhëheqës i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Novobërdë” Drejtorja për Regjistrimin e Automjeteve.

Ankuesi me datë 18.02.2022 parashtron kërkesën për kompensimi të shpenzimeve të udhëtimit me numër 184 tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin Civil mirëpo ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij dhe me datë 24.02.2022 parashtron përsëri kërkesën për kompensim me numër 119 tek Drejtoresha për Buxhet dhe Financa e Ministrisë së Punëve të Brendshme mirë po nuk merr përgjigje dhe ankuesi me datë 27.06.2022 parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 3742/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 01.07.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 21.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 15.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesa e ankuesit e datës 27.06.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 05.02.2020 i Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil; Kërkesa/e-mail i datave 10.03.2022, 04.02.2022; Kërkesa e ankuesit e datës 06.02.2022; Kërkesa e ankuesit e datës 11.01.2021 për kompensimin e shpenzimeve; e-mail i datave 29.08.2020, 19.08.2020; Akt emërimi i datës 31.01.2013; Kërkesa e datës 17.05.2019 për transferim të përkohshëm; Kërkesa për kompensim e ankuesit e datës 22.02.2022; Kërkesa e datës 24.02.2022 për kompensim; Kërkesa e ankuesit e datës 11.01.2021 për kompensim të shpenzimeve dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit me numër Ref.DRGJC/ARC-1/3 të datës 31.01.2013 është në vendin e punës *"Kordinator i QKRC Gjilan"* në Departamentin e Regjistrimit dhe Gjendjes Civile Njësia QKRC Gjilan, sipas Vendimit me numër 07 të datës 05.02.2020 të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencionit për Regjistrimin Civil ankuesi është caktuar Ushtrues i Detyrës *"Udhëheqës i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Novobërdë"* Drejtoria për Regjistrimin e Automjeteve ndërsa me datë 18.02.2022 parashtron kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit me numër 184 tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrimin Civil mirëpo ankuesi nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij dhe me datë 24.02.2022 parashtron përsëri kërkesën për kompensim me numër 119 tek Drejtoresha për Buxhet dhe Financa e Ministrisë së Punëve të Brendshme mirë po nuk merr përgjigje.

Ankuesi i pa kënaqur me mos marrjen e përgjigjeve lidhur me kërkesat e tij tek organi i punësimit, me datë 27.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendim ankimor që ta shqyrtoj ankesën e tij lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit si dhe më tutje shton se është i gatshëm për bashkëpunim me organin e punësimit që të bëhet një zgjidhje lidhur me zgjidhjen e çështjes së kompensimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 125 paragrafi 1 përcakton se: *"1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet*

*kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)" pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ".*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesi procedurën administrative/kërkesën për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit e ka filluar me kërkesën e datës 24.02.2022 me numër 203 ndërsa ankesën me numër protokolli 3742/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 27.06.2022, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 27.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej dy (2) muajsh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.575/2022

Valentina Kaçandolli Bektashi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.